

## Ne fokus/ Policia heq parkingun para stadiumit

nga AlbaniaSoccer

E premte, 11 Tetor 2013 17:35

---



Me urdher te ministrit te brendshem Saimir Tahiri, policia e Tiranes ka ndermarre nje aksion surprize. Parkingu i montuar disa muaj me pare para stadiumit Qemal Stafa eshte larguar brenda pak oresh. Te gjitha mjetet qe rrethonin sheshin para stadiumit jane hequr pak ore para ndeshjes Shqiperi - Zvicer gje e cila i jep me teper frymarrje tifozeve dhe delegacioneve te huaja qe vijne ne stadium. Kjo levizje eshte pershendetur nga i gjithe komuniteti sportiv.